

RELACION PËR
PROJEKTLIGJIN "PËR MIRATIMIN E MASAVE PËR ZBATIMIN E
AKTIT PËR TREGJET DIGJITALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
DHE RREGULLAT PËR PROMOVIMIN E DREJTËSISË DHE
TRANSPARENCËS NË SHËRBIMET E NDËRMJETËSIMIT ONLINE
PËR PËRDORUESIT E BIZNESIT"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN

Projektligji *"Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit"*, është propozim i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, bazuar në pikën 2, të nenit 100, të Kushtetutës si dhe bazuar në Piketat Përmbyllëse të Kapitullit 10, "Shoqëria e Informacionit dhe Media".

Projektligji synon të përafrojë në legjislacionin shqiptar dy acquis të Kapitullit 10 "Shoqëria e Informacionit dhe Media", Rregulloren (BE) 2019/1150 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online" (Rregullorja P2B), dhe Rregulloren (BE) 2022/1925 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 shtator 2022, "Për tregje të kontestueshme dhe të drejta në sektorin digjital" (Akti për Tregjet Digjitale).

Transpozimi i Aktit për Tregjet Digjitale të BE-së, është parashikuar gjithashtu në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.88, datë 22.2.2023.

Qëllimi i këtij projektligji është të kontribojë në funksionimin e duhur të tregut të brendshëm në Republikën e Shqipërisë, përmes rregullave që u sigurojnë përdoruesve biznes të shërbimeve ndërmjetëse online dhe përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve në lidhje me motorrët e kërkimit, një mjedis të drejtë dhe transparent, si dhe për sigurimin e gatishmërisë operationale të institucioneve shqiptare për bashkëpunimin, koordinimin dhe mbështetjen procedurale në zbatim të Rregullores (BE) 2022/1925, Akti i Tregjeve Digjitale, me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Projektligji vendos një kuadër ligjor të harmonizuar me praktikën e Bashkimit Evropian për rregullimin e tregjeve digjitale, duke bërë një plotësim të rëndësishëm e të nevojshëm në kuadrin ligjor shqiptar për promovimin e

konkurencës së ndershme në zhvillimet digjitale dhe përdorimin e gjerë të teknologjisë digjitale nga përdoruesit e biznesit.

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet këtij përafrimi janë:

- a) mbrojtja e përdoruesve të biznesit dhe e përdoruesve të faqeve të internetit të ndërmarrjeve nga praktikatat e padrejta dhe jotransparente të ofruesve të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe të motorëve të kërkimit online, nëpërmjet vendosjes së detyrimeve të qarta për kushtet e përgjithshme, njoftimin e ndryshimeve, arsyetimin e kufizimit, pezullimit ose ndërprerjes së shërbimit, transparencën e renditjes, të trajtimit të diferencuar dhe të qasjes në të dhëna, sistemin e brendshëm të ankesave dhe ndërmjetësimit;
- b) sigurimi i gatishmërisë operacionale të institucioneve shqiptare për bashkëpunimin me Komisionin Evropian në zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale, nëpërmjet caktimit të autoritetit përgjegjës, të rregullave për ndihmën ndaj Komisionit Evropian, për hetimet me nismë të Autoritetit, për informacionin nga palët e treta dhe për përqendrimet, si dhe të Planit të Gatishmërisë Operacionale;
- c) përmbushja graduale e detyrimeve të përafrimit sipas neneve 70 dhe 71 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe zbatimi, për fushën e këtij ligji, i angazhimit rajonal të parashikuar në nenin 20 të Vendimit nr. 2/2024 të Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s, të ratifikuar me ligjin nr. 50/2025;
- d) ngritja e kapaciteteve institucionale të Autoritetit të Konkurrencës për tregjet digjitale, nëpërmjet trajnimit, bashkëpunimit ndër-institucional dhe raportimit vjetor për zbatimin e ligjit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji është në përputhje me objektivin strategjik të Qeverisë për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe me angazhimet e marra në negociatat e anëtarësimit për kapitullin 10 "Shoqëria e Informacionit dhe Media", në kuadër të grupkapitullit 3, "Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse".

Projektligji u përgjigjet kërkesave të piketave përmbyllëse për kapitullin 10, ku kërkohet përafrimi i Aktit për Tregjet Digjitale. Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji, është në përputhje me Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2026.

Projektligji synon gjithashtu përmbushjen e angazhimit rajonal të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 20 të Vendimit nr. 2/2024 të Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s, "Për lehtësimin e tregtisë elektronike", të ratifikuar me ligjin nr. 50/2025, i cili parashikon përafrimin gradual të Palëve të CEFTA-s me acquis-in e Bashkimit Evropian për tregtinë elektronike, përfshirë rregullat për marrëdhëniet ndërmjet platformave dhe përdoruesve të biznesit.

Projektligji kontribuon në zbatimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.88, datë 22.2.2023, Agjendën Digjitale të Shqipërisë 2022–2026 dhe politikën shtetërore të konkurrencës, duke plotësuar, pa i mbivendosur, proceset paralele të përafrimit në fushën digjitale: ndryshimet në ligjin nr. 10128, datë 11.5.2009, "Për tregtinë elektronike", të ndryshuar, për gjeobllokimin e pajustifikuar; përafrimin e ardhshëm me Aktin për Shërbimet Digjitale; legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorëve dhe në harmoni me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Hartimi i tij është mbështetur nga projekti EU4Trade i GIZ, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, dhe ka mbajtur në konsideratë, udhëzimet e Komisionit Evropian të dhëna gjatë seminarit shumëvendësh TAIEX për Aktin për Tregjet Digjitale të datës 25 qershor 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për miratimin e masave për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë dhe rregullat për promovimin e drejtësisë dhe transparencës në shërbimet e ndërmjetësimit online për përdoruesit e biznesit”, hartohet në kuadër të procesit të integritit dhe përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të BE, në përputhje me angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të Kapitullit 10 “Shoqëria e informacionit dhe media”, dhe integritit gradual në Tregun e Vetëm Digjital të BE.

Përparësitë e projektligjit lidhen kryesisht me përafrimin e kuadrit ligjor shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e tregjeve digjitale, rritjen e transparencës dhe parashikueshmërisë në marrëdhëniet ndërmjet platformave online dhe përdoruesve të biznesit, forcimin e mbrojtjes së ndërmarrjeve, veçanërisht të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe krijimin e kushteve për konkurrencë të drejtë në ekonominë digjitale.

Projektligji kontribuon gjithashtu në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe në përgatitjen e Autoritetit të Konkurrencës për bashkëpunimin me Komisionin Evropian dhe për zbatimin e kuadrit të Aktit për Tregjet Digjitale pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në këtë mënyrë, projektligji synon të krijojë një mjedis digjital më transparent, të parashikueshëm dhe konkurrues, duke garantuar njëkohësisht mbrojtje më të mirë të përdoruesve të biznesit dhe të interesave të tyre në marrëdhëniet me ofruesit e shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe motorëve të kërkimit online.

Hartimi i këtij projektligji është i nevojshëm pasi në Republikën e Shqipërisë nuk ekzistojnë norma të posaçme rregulluese për marrëdhëniet e biznesit ndërmjet platformave online dhe ndërmarrjeve që tregtojnë nëpërmjet tyre. Kushtet e përgjithshme përcaktohen njëanshmërisht nga ofruesi dhe mund të ndryshohen pa njoftim paraprak, llogaritë e përdoruesve të biznesit mund të pezullohen ose të mbyllen pa deklaram të arsyeve, parametrat e renditjes dhe trajtimi i diferencuar i produkteve të vetë platformës nuk zbulohen, nuk ekziston sistem i brendshëm ankesash dhe asnjë autoritet nuk është ngarkuar me mbikëqyrjen.

Përdoruesit e biznesit në tregun e brendshëm të Bashkimit Evropian i gëzojnë këto garanci që prej 12 korrikut 2020, në bazë të Rregullores P2B; ndërmarrjet shqiptare, përfshirë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të tregtisë elektronike dhe të turizmit, që varen gjithnjë e më shumë nga platformat, mbeten pa mbrojtje. Sipas INSTAT-it, në vitin 2025, 28,0 % e ndërmarrjeve me 10 e më shumë të punësuar kryen shitje elektronike dhe 45,4 % e individëve 16–74 vjeç blenë online.

Nga ana tjetër, Rregullorja e (BE) 2022/1925, Akti për Tregjet Digjitale, zbatohet në mënyrë të centralizuar nga Komisioni Evropian ndaj ndërmarrjeve të përcaktuara si *gatekeeper*, por presupozon që çdo shtet anëtar të ketë autoritet kombëtar kompetent funksional, kanale bashkëpunimi dhe shkëmbimi informacioni, si dhe mekanizma për informacionin e palëve të treta. Gjithashtu kërkohet që vendet candidate të marrin masa përgatitore për anën operacionale për zbatimin e këtij akti.

Projektligji i trajton të dyja problematikat me një ligj të vetëm. Kjo zgjedhje mbështetet:

- së pari, në faktin që Rregullorja P2B dhe Akti për Tregjet Digjitale rregullojnë të njëjtin ekosistem – marrëdhëniet ndërmjet platformave online dhe përdoruesve të biznesit – dhe Akti ndërtohet mbi konceptet e Rregullores P2B (përdorues biznesi, shërbim ndërmjetësimi online, motor kërkimi online, renditje).

- së dyti, të dyja këto i besohen për çështjet e konkurrencës, të njëjtit autoritet, Autoritetit të Konkurrencës, duke u bazuar në kompetencat dhe funksionimin e këtij autoriteti sipas ligjit nr. 9121 datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar;. Gjithashtu mban parasysh harmonizimin me legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorit në çështje që Rregullorja P2B që transpozohet përmes këtij projektakti lidhet me aspekte të mbrojtjes së konsumatorit;
- së treti, ekspertiza që Autoriteti krijon me mbikëqyrjen e rregullave P2B shërben drejtpërdrejt për funksionet e autoritetit kombëtar që Akti për Tregjet Digjitale ia njeh autoritetit të konkurrencës në nenin 38, të këtij akti.

Propozimi është në harmoni me praktikën e BE-së. Neni 15 i Rregullores P2B ua lë shteteve zgjedhjen e modelit të zbatimit; Disa shtete anëtare kanë caktuar një autoritet publik (për shembull Italia, me ligjin nr. 178/2020, autoritetin e komunikimeve), ndërsa të tjera mbështeten kryesisht në zbatimin privat (Gjermania). Projektligji kombinon mbikëqyrjen publike me të drejtën e padisë së organizatave përfaqësuese dhe të përdoruesve individualë.

Për Aktin për Tregjet Digjitale, projektligji ndjek udhëzimet e Komisionit Evropian për vendet candidate: nuk krijon regjim kombëtar paralel me Rregulloren 2022/1925/EU, nuk transponon detyrimet materiale të neneve 5, 6 dhe 7, të Rregullores 2022/1925/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 shtator 2022, "Për tregje të kontestueshme dhe të drejta në sektorin digjital" (Akti për Tregjet Digjitale), dhe nuk u vendos detyrime ose sanksione *gatekeeper*-ëve dhe kufizohet te caktimi i autoritetit përgjegjës, te ndihma për ushtrimin e kompetencave të Komisionit Evropian, te hetimet me nismë të Autoritetit sipas nenit 38(7) të Aktit, te informacioni nga palët e treta dhe për përqendrimet, si dhe te masat e gatishmërisë operationale.

Dispozitat që presupozojnë zbatimin me anëtarësimin në Bashkimin Evropian, aktivizohen vetëm nga ajo datë, sipas teknikës legjislative të njohur tashmë në procesin shqiptar të përafrimit në kuadër të integritetit në BE.

Efektet e pritshme të projektligjit janë: rritja e transparencës dhe e parashikueshmërisë kontraktuale për përdoruesit e biznesit; ulja e mosmarrëveshjeve ndërmjet platformave dhe ndërmarrjeve dhe zgjidhja e tyre me kosto të ulët nëpërmjet sistemit të brendshëm të ankesave dhe ndërmjetësimit; barazimi i pozitës së ndërmarrjeve shqiptare me atë të ndërmarrjeve të tregut të brendshëm dhe të Palëve të tjera të CEFTA-s; forcimi i kapacitetit analitik dhe informativ të Autoritetit të Konkurrencës për tregjet digjitale; përmbushja e verifikueshme e detyrimit të përafrimit për kapitullin 10;

dhe ushtrimi pa vonesë i funksioneve të autoritetit kombëtar dhe i bashkëpunimit me Komisionin Evropian nga data e anëtarësimit.

Kostot e pajtueshmërisë për ofruesit vendas janë të kufizuara dhe zbuten nga përjashtimi i ndërmarrjeve të vogla dhe i mikrondërmarrjeve nga sistemi i brendshëm i ankesave dhe nga zbatimi i shtyrë me 6 muaj i krerëve II–IV; Vlerësimi i hollësishëm i ndikimeve paraqitet në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit që shoqëron projektligjin.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDERKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 78, 83 pika 1, të Kushtetutës, dhe plotëson kuadrin ekzistues ligjor në fushën e tregjeve digjitale, konkurrencës, tregtisë elektronike, mbrojtjes së konsumatorëve, mbrojtjes së të dhënave personale, ndërmjetësimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Gjithashtu ky projektligj është hartuar në përputhje me angazhimet në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian dhe acquis të BE-së.

Projektligji harmonizohet me legjislacionin në fuqi, në veçanti me: ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, sipas të cilit organizohet dhe funksionon Autoriteti dhe dispozitat e të cilit zbatohen për procedimet, inspektimet dhe masat administrative sipas këtij ligji (nenet 5, 19, 21, 24 dhe 26); ligjin nr. 10128, datë 11.5.2009, "Për tregtinë elektronike", të ndryshuar, të cilit i referohet përkufizimi i shërbimit të shoqërisë së informacionit; legjislacionin për mbrojtjen e konsumatorëve, që mbetet plotësisht i zbatueshëm (neni 3, pika 4); ligjin nr. 124/2024, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", dhe kompetencat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (nenet 13 dhe 30); ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011, "Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve", të ndryshuar (nenet 16 dhe 17); ligjin nr. 43/2022, "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme" (neni 15, pika 6); Kodin Civil, dispozitat e të cilit për vlefshmërinë, lidhjen, efektet dhe zgjidhjen e kontratës nuk preken (neni 3, pika 5);

Në planin ndërkombëtar, projektligji zbaton nenet 70 dhe 71 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, të ratifikuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, dhe nenin 20 të Vendimit nr. 2/2024 të Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s, të ratifikuar me ligjin nr. 50/2025.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji synon përafrim të pjesshëm me Rregulloren (BE) 2022/1925 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 shtator 2022, "Për tregje të kontestueshme dhe të drejta në sektorin digjital dhe për ndryshimin e Direktivave (BE) 2019/1937 dhe (BE) 2020/1828 (Akti për Tregjet Digjitale)" si dhe përafron plotësisht Rregulloren (BE) 2019/1150 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 20 qershor 2019, "Për promovimin e drejtësisë dhe transparencës për përdoruesit e biznesit të shërbimeve të ndërmjetësimit online".

Përafrimi i legjislacionit shqiptar me kuadrin e Bashkimit Evropian për tregjet digjitale është i rëndësishëm për përmbushjen e angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integritetit evropian, lidhur me piketat përmbyllëse të Kapitullit 10, "Shoqëria e Informacionit dhe Media". Gjithashtu ai i shërben krijimit të një kuadri ligjor të qartë, transparent dhe të parashikueshëm për funksionimin e tregjeve digjitale dhe synon të sigurojë përgatitjen e nevojshme institucionale dhe operacionale të autoriteteve shqiptare për bashkëpunimin dhe zbatimin e këtij kuadri nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Përafrimi me rregullat e Rregullores (BE) 2019/1150, synon forcimin e transparencës dhe të drejtësisë në marrëdhëniet ndërmjet ofruesve të shërbimeve të ndërmjetësimit online dhe përdoruesve të biznesit, duke garantuar mekanizma efektivë për trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Përafrimi me Rregulloren P2B dhe përgatitja për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale janë ndër kërkesat e kapitullit 10 "Shoqëria e informacionit dhe media" në negociatat e anëtarësimit, pjesë e raportimit periodik për progres raportin me Bashkimin Evropian në lidhje me Kapitullin 10.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 32 nene, të ndara në 8 krerë.

Kreu I – Dispozita të përgjithshme (nenet 1–5)

Neni 1, përcakton qëllimin e ligjit: sigurimin e një mjedisi të drejtë dhe transparent për përdoruesit e biznesit dhe për përdoruesit e faqeve të internetit të ndërmarrjeve, gatishmërinë operacionale të institucioneve për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale dhe përgatitjen e Autoritetit për bashkëpunimin me

Komisionin Evropian dhe për ushtrimin, nga data e anëtarësimit, të kompetencave të nenit 38 të Aktit.

Neni 2, përcakton objektin ku përfshihen: përcaktimi i rregullave për drejtësinë dhe transparencën sipas Rregullores P2B, si dhe masat kombëtare të gatishmërisë institucionale, bashkëpunimit dhe mbështetjes procedurale për Aktin për Tregjet Digjitale.

Neni 3, përcakton fushën e zbatimit: duke qartësuar që krerët II–V, zbatohen për shërbimet e ndërmjetësimit online dhe motorët e kërkimit online që u ofrohen përdoruesve të biznesit të vendosur në Republikën e Shqipërisë, të cilët u ofrojnë mallra ose shërbime konsumatorëve në Republikën e Shqipërisë ose në një Palë tjetër të CEFTA-s, si dhe përdoruesve të biznesit të vendosur në një Palë tjetër të CEFTA-s që u ofrojnë mallra ose shërbime konsumatorëve në Republikën e Shqipërisë (neni 1(2) i Rregullores P2B dhe neni 20 i Vendimit nr. 2/2024 të Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s), me përjashtimet e nenit 1(3) të Rregullores (shërbimet e pagesave dhe mjetet e reklamimit online); dhe se krerët VI dhe VII, zbatohen nga Autoriteti dhe organet e tjera publike;

Neni 4, përmban përkufizimet sipas përkufizimeve në Rregulloren P2B dhe termat e përbashkët (data e anëtarësimit, shtet anëtar, Palë e CEFTA-s, Autoriteti, Ministria, Akti i Tregjeve Digjitale); pika 2 i referohet në mënyrë dinamike nenit 2, të Aktit të Tregjeve Digjitale të BE-së për termat e krerëve VI dhe VII.

Neni 5, cakton Autoritetin e Konkurrencës nga data e anëtarësimit, si autoritet përgjegjës për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjit, garanton pavarësinë e tij sipas ligjit nr. 9121/2003, parashikon funksionet e autoritetit kombëtar sipas neneve 1(6) dhe 38 të Aktit të Tregjeve Digjitale nga data e anëtarësimit dhe detyrimin e bashkëpunimit të autoriteteve dhe organeve të tjera publike. Gjithashtu në këtë nen përcaktohen në pikën 3, dhe autoritet e tjera përgjegjëse lidhur me çështje që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit për dispozitat e krerëve II-IV, sipas legjislacionit në fuqi.

Kreu II – Kushtet e përgjithshme dhe marrëdhënia kontraktuale me përdoruesit e biznesit (nenet 6–9)

Neni 6, përafron nenin 3(1), (3) dhe (5) të Rregullores P2B: kushtet e përgjithshme hartohen në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, janë lehtësisht të disponueshme, përcaktojnë arsyet e pezullimit, ndërprerjes ose kufizimit, informojnë për kanalet shtesë të shpërndarjes dhe për efektet mbi pronësinë intelektuale;

Neni 7, përafron nenin 3(2)–(4): çdo ndryshim i kushteve njoftohet në mjet të qëndrueshëm, me afat njoftimi jo më të shkurtër se 15 ditë, me të drejtën e përdoruesit të biznesit për të zgjidhur kontratën ose për të hequr dorë nga afati, me përjashtimet për detyrimet ligjore dhe rreziqet e sigurisë kibernetike; ndryshimet e zbatuara në kundërshtim me nenin janë të pavlefshme.

Neni 8, përafron nenin 4: deklarata me arsye për kufizimin ose pezullimin, njoftimi 30-ditor për ndërprerjen, mundësia e sqarimit nëpërmjet sistemit të brendshëm të ankesave, rikthimi në gjendjen e mëparshme, përjashtimet dhe përmbajtja e deklaratës.

Neni 9, përafron nenin 8: ndalimi i ndryshimeve me efekt prapaveprues, informacioni për kushtet e zgjidhjes së kontratës dhe përshkrimi i qasjes në të dhënat e ruajtura pas mbarimit të kontratës.

Kreu III – Transparenca (nenet 10–14)

Neni 10, përafron nenin 5, të Rregullores P2B për parametrat kryesorë të renditjes, efektet e shpërblimit mbi renditjen, mundësinë e përdoruesit të faqes së internetit të ndërmarrjes për të shqyrtuar njoftimin e palës së tretë, përmbajtjen e përshkrimeve dhe mbrojtjen e algoritmeve e të sekretit tregtar.

Neni 11, përafron nenin 6, të Rregullores P2B për mallrat dhe shërbimet ndihmëse.

Neni 12, përafron nenin 7, të Rregullores P2B për trajtimin e diferencuar të mallrave ose shërbimeve të vetë ofruesit ose të ndërmarrjeve që ai kontrollon.

Neni 13, përafron nenin 9, të Rregullores P2B për qasjen teknike dhe kontraktuale në të dhënat personale dhe të dhënat e tjera, duke ruajtur legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 14, përafron nenin 10 të Rregullores P2B, për kufizimet e ofrimit të kushteve të ndryshme me mjete të tjera, pa cenuar legjislacionin e konkurrencës dhe atë për praktikatat e padrejta tregtare.

Kreu IV – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve (nenet 15–17)

Neni 15, përafron nenin 11, të Rregullores P2B: sistemi i brendshëm i trajtimit të ankesave, lehtësisht i qasshëm dhe pa pagesë, parimet e trajtimit, objekti i ankesave, masat e ofruesit, informacioni në kushtet e përgjithshme dhe

publikimi vjetor i të dhënave për funksionimin e tij; ndërmarrjet e vogla dhe mikrondërmarrjet, sipas ligjit nr. 43/2022, përjashtohen.

Neni 16, përafron nenin 12, të Rregullores P2B, ofruesi mund të identifikojë në kushtet e përgjithshme dy ose më shumë ndërmjetës për zgjidhjen jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve, duke mbajtur parasysh kërkesat e legjislacionit për ndërmjetësimin.

Neni 17, përafron nenin 13, të Rregullores P2B duke ngarkuar Autoritetin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për drejtësinë, të nxisë krijimin e organizatave të ndërmjetësimit të specializuar.

Kreu V – Mbikëqyrja, zbatimi dhe mbrojtja gjyqësore (nenet 18–21)

Neni 18, përafron nenin 14 të Rregullores P2B: e drejta e padisë para gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm për ndalimin ose pushimin e shkeljeve për organizatat dhe shoqatat përfaqësuese dhe për organet publike të ngarkuara shprehimisht me ligj; kërkesat për organizatat përcaktohen me referim te legjislacioni në fuqi për paditë përfaqësuese; ruhet e drejta individuale e padisë dhe e shpërblimit të dëmit sipas kushteve të përgjegjësisë civile.

Neni 19, përafron nenin 17, të Rregullores P2B, për nxitjen e kodeve të sjelljes, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për ekonominë dhe fushën digjitale.

Neni 20, parashikon mbikëqyrjen e zbatimit dhe masat korigjuese në rast mospërmbushje të detyrimeve nga ofruesit e shërbimit. Duke respektuar rregullimet ligjore në fuqi është parashikuar në këtë nen që autoritetet përgjegjëse sipas nenit 5, brenda fushës së vet të përgjegjësisë mbikëqyrin zbatimin e dispozitave të krerëve II, III dhe IV, të këtij ligji dhe kur autoriteti përgjegjës konstaton se ofruesi i shërbimeve të ndërmjetësimit online ose ofruesi i motorit të kërkimit online nuk ka përmbushur një detyrim të parashikuar në krerët II, III ose IV, njofton ofruesit e shërbimit mbi mospërmbushjen e konstatuar, dhe me vendim të arsyetuar kërkon marrjen e masave korigjuese brenda një afati të arsyeshëm kohor, dhe që kur shkelja cënon konkurrencën e drejtë, masat merren nga Autoriteti i Konkurrencës sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës dhe kur shkelja cënon të drejtat e konsumatorit, masat merren sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit.

Kreu VI – Zbatimi i Aktit për Tregjet Digjitale në Republikën e Shqipërisë, që përfshin nenet 21–25, parashikon masat për zbatimin e Rregullores

2022/1925/EU Akti për Tregjet Digjitale duke mbajtur parasysh udhëzimet e Komisionit Evropian të dhëna gjatë seminarit shumëvendësh TAIEX për Aktin për Tregjet Digjitale të datës 25 qershor 2026.

Neni 21, përcakton Autoritetin e Konkurrencës si autoritet përgjegjës për bashkëpunimin me Komisionin Evropian: deri në anëtarësim nëpërmjet asistencës teknike, shkëmbimit të informacionit dhe dialogut teknik; nga data e anëtarësimit, nëpërmjet Rrjetit Evropian të Konkurrencës, sipas neneve 37, dhe 38, të Aktit të Tregjeve Digjitale të BE-së.

Neni 22, parashikon ndihmën që Autoriteti i Konkurrencës do japë, pas anëtarësimit në BE, në ushtrimin e kompetencave të Komisionit Evropian nga data e anëtarësimit ku përfshihet: informacioni sipas nenit 21 të Aktit të Tregjeve Digjitale të BE-së, intervistat sipas nenit 22 të këtij akti, ndihma gjatë inspektimeve sipas nenit 23, hetimet e tregut sipas nenit 16(5) dhe zyrtarët në monitorim sipas nenit 26(2) të Aktit, duke respektuar legjislacionin e konkurrencës.

Neni 23, sipas nenit 38(7) të Aktit të Tregjeve Digjitale, parashikon hetimet me nismë të Autoritetit për mospërputhje të mundshme me nenet 5, 6 dhe 7 të Aktit në territorin e Republikës së Shqipërisë: njoftimi paraprak i Komisionit Evropian, përcjellja e gjetjeve, ndalimi i vendimeve kombëtare për konstatim shkeljeje ose sanksione, ndërprerja e hetimit kur Komisioni fillon procedim dhe njoftimi i procedimeve ndaj *gatekeeper*-ëve sipas legjislacionit të konkurrencës.

Neni 24, përafron nenin 27, të Aktit të Tregjeve Digjitale të BE-së për informacionin nga palët e treta dhe ngarkon Autoritetin të krijojë kanalin e posaçëm të komunikimit.

Neni 25, lidh informacionin për përqendrimet sipas nenit 14, të Aktit të Tregjeve Digjitale të BE-së, me kontrollin kombëtar të përqendrimeve.

Kreu VII – Masat përgatitore (nenet 26–27)

Neni 26, parashikon Planin e Gatishmërisë Operacionale për zbatimin e Aktit për Tregjet Digjitale, që Autoriteti miraton brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, pas konsultimit me autoritetet e tjera publike: përmbajtja e planit (rezultati i pritshëm, afati, struktura përgjegjëse, burimet dhe treguesi i realizimit për çdo masë), përditësimi i tij sipas nevojave operacionale dhe fazës së procesit të integritetit, si dhe paraqitja e kërkesave për burime pranë Kuvendit dhe institucioneve përgjegjëse.

Neni 27, parashikon trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të Autoritetit, me pjesëmarrjen e punonjësve të organeve të tjera publike dhe me mbështetjen e instrumenteve të asistencës së Bashkimit Evropian dhe të autoriteteve homologe, pa krijuar funksione të reja për organet e tjera.

Kreu VIII – Dispozita të përbashkëta, kalimtare dhe të fundit (nenet 28–32)

Neni 28, rregullon mbrojtjen e të dhënave personale dhe bashkëpunimin me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 29, rregullon ruajtjen e konfidencialitetit tregtar: kufizimi i përdorimit të informacionit të mbledhur për mbikëqyrjen e krerëve II–IV, kufizimi i qëllimit për informacionin e shkëmbyer sipas neneve 38 dhe 14 të Aktit nga data e anëtarësimit dhe detyrimi i ruajtjes së sekretit profesional e tregtar; vendimet dhe raportet publikohen në version jokonfidencial.

Neni 30, parashikon përballimin e efekteve financiare nga buxheti i miratuar i Autoritetit dhe i institucioneve të tjera përgjegjëse dhe nga programet e asistencës.

Neni 31, përmban dispozitat kalimtare: krerët II, III dhe IV zbatohen 6 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit, që u lejon ofruesve përshtatjen e kushteve të përgjithshme dhe të praktikave; nga data e anëtarësimit, krerët II–V shfuqizohen, pasi Rregullorja P2B bëhet drejtpërdrejt e zbatueshme. Meqenëse neni 15 i Rregullores P2B kërkon që çdo shtet anëtar të sigurojë zbatimin e saj me autoritet dhe masa kombëtare, kreu V (mbikëqyrja, masat korigjuese dhe e drejta e padisë) duhet të mbetet në fuqi edhe pas anëtarësimit, me përshtatjen e referencave të Rregullorja;

Neni 32, parashikon hyrjen në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohet Autoriteti i Konkurrencës, që caktohet si autoriteti përgjegjës për bashkëpunimin, koordinimin dhe mbështetjen procedurale në zbatim të Rregullores (BE) 2022/1925, Akti i Tregjeve Digjitale, me anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Nga data e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, Autoriteti i Konkurrencës është autoriteti kombëtar që vepron sipas nenit 38 të Aktit për Tregjet Digjitale të BE-se; Gjithashtu projektligji në piken 3 të nenit 5, përcakton autoritetin përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorit dhe organet e tjera publike, si autoritete bashkëpunuese për ndjekjen e zbatimit të përcaktimeve në krerët II–V të projektligjit brenda kompetencave të tyre.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me mbështetjen e ekspertëve të projektit EU4Trade të GIZ, të bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian.

Në procesin e hartimit janë zhvilluar disa takime ndër-institucionale në periudhën prill-korrik 2026. Me datë 25 qershor 2026 u zhvillua nga Komisioni Evropian workshopi i TAIEX për Rregulloren e Aktit të Tregut Digjital. Nga Komisioni Evropian u dhanë udhëzime për vendet candidate duke sqaruar që para anëtarësimit kërkohet përgatitja operationale dhe caktimi i autoritetit përgjegjës për bashkëpunimin me Komisionin Evropian sipas parashikimeve të Rregullores 2022/1925/EU. Në këtë seminar morën pjesë përfaqësues të MIE, Autoritetit të Konkurrencës si dhe u ndoq online nga disa institucione si MEI, AKEP.

Me datë 7 korrik 2026, nga MIE në bashkëpunim me GIZ u zhvillua tryeza e rrumbullakët për transpozimin e Aktit për Tregjet Digjitale bazuar në udhëzimet e dhëna nga Komisioni Evropian në datë 25 qershor 2026, të cilit janë pasqyruar në projektligjin e përgatitur.

Në takimet e zhvilluara kanë marrë pjesë përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, strukturat përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit dhe tregun, përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, AMA-s Bankës së Shqipërisë, etj.

Projektligji do kalojë për konsultim publik sipas ligjit nr. 146/2014, "Për njoftimin dhe konsultimin publik", nëpërmjet Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, për një periudhë jo më të shkurtër se 20 ditë pune.

Për prezantimin e projektligjit është planifikuar për datën 24 shtator 2026. një tryezë diskutimi me institucionet publike dhe shoqatat e biznesit.

Projektligji do t'u dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Shtetit dhe Kryenegociatorit, Autoritetit të Konkurrencës, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare të drejtpërdrejta për buxhetin e shtetit.

Projektligji parashikon masa për rritjen e kapaciteteve të Autoritetit të Konkurrencës deri në anëtarësimin e Shqipërisë në BE, gjë që do të kërkojë planifikimin dhe miratimin e nevojshëm të burimeve financiare dhe teknike për Autoritetin sipas legjislacionit në fuqi.

MINISTRI

Enea Karakaçi